



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Cfarë janë titujt qeveritarë?

- Titujt qeveritarë janë instrumente borxhi të cilët emetohen dhe garantohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë emeton tituj qeveritare rregullisht në treg nëpërmjet ankandeve
- Titujt emetohen me vlera të caktuara, të cilat blihen nga individë, nga banka apo nga institucione të tjera financiare për një kohë të përcaktuar më parë. Pas mbarimit të kësaj kohe (ose kur maturohen titujt) qeveria i riblen letrat me vlerë dhe së bashku me çmimin fillestar me të cilin i ka shitur, ajo i paguan edhe një interes mbajtësit të tyre.
- Ky interes është shpenzim për qeverinë dhe fitim për investitorin.

Cfare instrumentesh ofron aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë?

- MFE ofron dy kategori titujsh: bono thesari dhe obligacione.
- Bonot e thesarit janë tituj afatshkurtër me maturitete 3-, 6- ose 12-mujore.
- Ndërsa obligacionet janë tituj afatmesëm dhe afatgjatë me maturitete 2-, 3-, 5-, 7-, 10- dhe 15-vjecare.

Cilat janë avantazhet e investimit në tituj qeveritarë për qytetarët në vend?

- Duhet theksuar se titujt qeveritarë janë instrumente borxhi të cilët emetohen dhe garantohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, këta tituj **mbartin risk më të ulët** në krahasim me forma të tjera investimi dhe ndihmojnë në diversifikimin e portofoleve të investimit në tërësi.
- Titujt qeveritarë janë të **tregtueshëm në tregun sekondar**, pra në rast se qytetarit në një moment të caktuar i duhet likuiditet, mund të shesë titullin që zotëron përpara datës së maturimit të specifikuar në kontratë, me çmimin që ofron tregu në atë moment.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË

Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e individëve në ankandet e titujve qeveritarë për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë?

Një bazë e diversifikuar e investorëve është e rëndësishme jo vetëm për emetuesin, por edhe për tregun në tërësi, në mënyrë që të reduktohet ekspozimi i tepërt i sektorëve të caktuar kundrejt rreziqeve potenciale.

Sigurisht që individët nuk janë e vetmja kategori e cila do kontribuonte në këtë diversifikim. Kategoritë tjera mund të jenë fondet e pensioneve, apo skemat e investimit kolektive

Prandaj, mbi të gjitha në kontekstin ekonomik aktual kur normat janë në rritje, komunikimi me investorët individualë është identifikuar si më direkt dhe me impakt të shpejtë.

Cilat janë karakteristikat kryesore të bonove të thesarit dhe të obligacioneve?

Bonot e thesarit janë instrument që tregtohen me zbritje, pra përfitimi nga investimi është diferenca midis vlerës nominale që MFE shpall dhe cmimit të blerjes. Shuma minimale me të cilën mund të merret pjesë në ankandet e bonove të thesarit është 300 mijë lekë, ose 2 mijë EUR/USD.

Çdo investor që rezulton i suksesshëm pas ankandit paguan çmimin që ka ofruar (pra aplikohet i ashtuquajtur 'mekanizmi me shume cmime'). Kërkesat e qytetarëve mund të jenë konkurruese (ofrohet shuma dhe yieldi) ose jo-konkurruese (ofrohet vetëm shuma dhe merret yieldi mesatar).

Obligacionet nga ana tjetër tregtohen me *par value*, pra vlera nominale dhe cmimi i blerjes janë të barabartë dhe interesi paguhet çdo 6 muaj. Shuma minimale e investimit 300 mijë lekë ose 3 mijë EUR/USD.

Persa i përket mekanizmit të cmimit, ky i fundit është uniform, pra të gjithë investorët marrin normen maksimale të interesit të pranuar nga MFE. Përjashtim bëjnë vetëm titujt referencë 3 dhe 5 vjecare për të cilët mekanizmi i cmimeve është i njëjtë me bonot e thesarit.

Duhet theksuar se rasti i rihapjes së obligacioneve (pra kur për të njëjten linjë obligacioni, me të njëjtin kod, emetohet një shumë shtesë) është më kompleks për t'u kuptuar nga ana teknike, prandaj qytetarët këshillohet të informohen paraprakisht në faqen e MFE mbi karakteristikat e këtyre emetimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Cilat janë kanalet përmes të cilave individët mund të marrin pjesë në ankandet e titujve qeveritarë?

Cdo qytetar mund të marrë pjesë në ankandet e titujve qeveritarë nëpërmjet sporteleve në degët e Bankës së Shqipërisë (vetëm për bonot e thesarit) ose nëpërmjet bankave të nivelit të dytë (për bonot e thesarit dhe për obligacionet).

Procedura për të marrë pjesë në ankand nëpërmjet Bankës së Shqipërisë ndiqet si më poshtë:

1. Hapja e një llogarie Cash-i për pjesëmarrje në ankandin e bonove të thesarit, pranë një banke të nivelit të dytë
2. Derdhja e fondeve që do të investohen në llogarinë e Cash-it të hapur për këtë qëllim.
3. Marrja nga banka e nivelit të dytë e IBAN-it dhe vërtetimit për bllokimin e shumës për pjesëmarrje në ankandet e Bonove të Thesarit.
4. Paraqitja e IBAN-t të llogarisë së cash-it të hapur dhe vërtetimit për bllokimin e shumës për pjesëmarrje në ankandet e Bonove të Thesarit pranë sporteleve të Bankës së Shqipërisë për të hapur llogarinë e titullit pranë këtyre sporteleve, dhe për të plotësuar kërkesën për pjesëmarrje në ankandin e bonove të thesarit

Procedura për të marrë pjesë në ankand nëpërmjet subjekteve të licensuara nga AMF është si më poshtë:

1. Hapja e një llogarie cash-i dhe titulli për pjesëmarrje në ankandin e titujve qeveritare, pranë subjektit të licencuar nëpërmjet se cilit kërkohet të merret pjesë në ankand.
2. Derdhja e fondeve që do të investohen në llogarinë e hapur për këtë qëllim.
3. Të plotësojë kërkesën për pjesëmarrje në ankand.

Sportelet për individët ndodhen në degët e BSH-së si më poshtë:

- **Tiranë:** Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A
- **Elbasan:** Lagjja "28 Nëntori", Rruga "11 Nëntori", pranë Prefekturës Elbasan
- **Gjirokastër:** Lagjja "Varosh", pranë Qarkut Gjirokastër
- **Korçë:** Bulevardi "Gjergj Kastrioti"
- **Lushnje:** Lagjja "Kongresi i Lushnjes", prapa Bashkisë Lushnje
- **Shkodër:** Lagjja "Qemal Stafa", Rruga "13 Dhjetori", pranë Prefekturës Shkodër